



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM
Nr. 35, Datë 27.03.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
"ENSCO TRADING (ALBANIA)" SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "d", të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma "e", 5, pika 1, gërma "e", 10, pikat 1 dhe 3, dhe 16 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 586/7 prot., datë 26.03.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "*Mbi kërkesën e shoqërisë "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike*",

Konstatoi se:

- Shoqëria "ENSCO Trading (Albania)" sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 586/1 prot., datë 09.02.2024 dhe nr. 586/2 prot., datë 15.02.2024, ka përcjellë nëpërmjet adresës së e-mailit të plotësuar në anglisht Aneksin 1 të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*" e ndryshuar.
- ERE me shkresën nr. 586/3 prot., datë 16.02.2024, i ka bërë me dije shoqërisë se aplikimi nuk është sjellë në formën e duhur dhe ka kërkuar të bëhen saktësimet/plotësimet përkatëse referuar kërkesave të rregullores së licencimit nenit 8, pika 3, dokumentacioni duhet të depozitohet në gjuhën shqipe, në format origjinal/njësuar me origjinalin, si dhe një kopje në format elektronik (CD ose USB).
- Shoqëria nëpërmjet e-mailit protokolluar në ERE nr. 586/4 prot., datë 19.02.2024 ka kërkuar informacion shtesë në lidhje me këtë aplikim, i cili konsistonte nëse është marrë nga ana jonë pagesa e aplikimit bërë nga shoqëria si dhe nëse është e plotë forma me dokumentacionin e përcjellë së fundmi prej saj. ERE ka vijuar me kthim përgjigje nëpërmjet adresës së e-mailit e cila në vijim edhe është protokolluar me nr. 586/5 prot., datë 20.02.2024 dhe i ka risjellë në

vëmendje duke i referuar shkresën e përcjellë më në ERE me nr. 586/3, datë 16.02.2024 me anë të së cilës ka bërë sqarimet mbi saktësimin e dokumentacionit/plotësimet përkatëse.

- Me shkresën nr. 586/6 prot., datë 04.03.2024 shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 450 Seria T19, është 06.09.2024).
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj në datën 04.03.2024, pra brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c” si dhe nenin 16, pika 7, por në kuadër të një dosje të plotë, vlen të informojë në lidhje me sa më poshtë:

Neni 16 Rinovimi i licencës

- **gërma “b”**: *Shoqëria duhet të sjelli informacion më të plotë në lidhje me dokumentacionin për të cilin shprehet se nuk ka pësuar ndryshim që nga mometi i licencimit pranë ERE-s.*
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ENSCO Trading (Albania)” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 07.09.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NE DETYRE

Erjola SADUSHI